

Data: 15 /09/2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ZËVENDËSIMI I TUBACIONEVE DHE PAJISJEVE TË SIGURISË PËR SISTEMIN E SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË DRENAZHEVE NË BIEFIN E POSHTËM NË HEC VAU DEJËS”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 15,000,000 (Pesëmbëdhjetëmilion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet*

publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se 40% e fondit limit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) SSH EN ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) SSH EN ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- c) SSH EN ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” - Ky standart është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këtë çertifikatë është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të këtë në stafin e tij:

- Minimumi 1(një) inxhinier mekanik.
- Minimumi 2(dy) axhustator.
- Minimumi 2(dy) saldator të çertifikuar me SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent
- Minimumi 2(dy) polumbarë të çertifikuar për zhytje në ujëra të ëmbla në thellësi deri në 15 m.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Çertifikatat e mësipërme të vlefshme,
- Diploma
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2023 –Gusht 2023

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure.

Konkretisht:

-*Inxhinieri mekanik* është i nevojshëm pasi procesi i zëvendësimit konsiston në demontimin e sistemit ekzistues dhe instalimin e sistemit të ri. Për instalimin të ri është e nevojshme të bëhen matjet përkatëse, të realizohen vizatimet e nevojshme, të zgjedhen elementët e rinj, të përcaktohen procedurat e saldimit, të përcaktohen vlerat e shtrëngimit të bulonave sipas standarteve etj.

-*Axhustatorët* janë për nevojshëm pasi dohet të kryejnë pastrimin e tegelave të saldimit pas çdo kalimi dhe pastrimin përfundimtar të tegelit të saldimit.

-*Saldatorët* janë të nevojshëm pasi procesi i zëvendësimit konsiston në furnizimin e tubacioneve të rinj dhe instalimin e tyre. Instalimi i tyre do të realizohet me antë të procesit të saldimit. Saldatorët janë kërkuar të jenë të çertifikuar sipas standartit SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent pasi proceset e saldimit të referuara në ISO 9606-1 përfshijnë ato procese saldimi me shkrirje të cilat janë përcaktuar si saldim manual ose pjesërisht i mekanizuar.

-*Polumbarët* janë të nevojshëm pasi tubacionet të shkarkimit në biefin e poshtëm janë nën nivelin e ujit të rezervuarit për këtë arsye izolimi i është i nevojshme të kryhet nën ujë.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të disponojë minimalisht pajisjet si më poshtë:

- 2(dy) pajisje saldimit për elektroda inoksi;
- 1(një) furrë tharje për elektroda;
- 2(dy) pajisje axhustimi me përmasa të vogla;
- 1(një) pajisje për prerje betoni dhe disqet përkatëse

- 2(dy) complete pajisje për zhytje
- 1(një) pompë për largim ujrash

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

✚ Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh (faturë tatimore të shitblerjes, zhdoganim, ose kontrate qiraje të noterizuar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Konkretisht:

-Pajisjet e saldimit për elektroda inoksi është janë kërkuar pasi tubacionet të cilat do të furnizohen janë parashikuar të jenë çelik inoks, për këtë arsye minimalisht saldimit duhet të kryhet me elektroda inoksi dhe pajisjet që do të kryejnë saldimit duhet të jenë të përshtatshme për keto lloj elektrodash. Pajisjet duhet të jenë për secilin ngasaldatorët e kërkuar.

-Furra për tharjen e elektrodave të inoksit është e nevojshme pasi referuar zones ne të cilën do të vendoset sistemi i ri e cila është me lagështi të kosiderueshme. Atëherë duhet që për realizimin sa më konfort të procesit të saldimit është e nevojshme që elektrodat të thahen para se të përdoren.

-Pajisjet e axhustimit janë të rëndësishme që secili axhistator të jetë i pajisur me me këto pajisje me qëllim realizimin e proceseve të punës për axhustim.

-Pajisje për prerje betoni është i nevojshëm pasi mund të lind nevoja për zgjerimin e përmasave të pusëtës kryesore e cila është me beton.

-Komplete pajisje për zhytje janë të nevojshme për polumbarët gjatë zhytjeve.

-Pompa për largimin e ujrave është e nevojshme pasi puseta ku do të montohet saraçineska kryesore, vazhdimisht grumbullon ujë nga filtrimet e strukturave të betonit. Demontimi I saraçineskës ekzistuese dhe instalimi i saraçineskës së re kërkon të mos jetë I pranishëm uji në pusetë. Për këtë arsye është e nevojshme të instalohet një pompë e përkohshme e cila do të largojë ujin.

.Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Objekt i specifikimeve teknike është rinovimi i sistemit të tubacioneve të largimit të ujerave nga pompat e drenazhit në sallën e makinerive në HEC Vau i Dejës. Gjendja aktuale e sistemit të tubacioneve është e amortizuar ku konstatohen zhvillim i fenomenit të oksidimit të metalit të tubacioneve dhe mosfunksionim i elementëve të sigurisë së sistemit të tilla si saraçineska dhe kundralvula.

Elementët e këtij sistemi punojnë në prani të ujit dhe në prani të goditjeve hidraulike të cilat shkaktohen nga fenomeni i grushtit hidraulik sa herë që vendosen në punë pompat e drenazhit. Nisur nga këto kushte, për të eliminuar fenomenet e korrosionit në specifikime janë kërkuar të gjithë elementet me material çelik që i reziston korrosionit dhe me qëllim përmirësimin nga ana e qëndrueshmërisë mekanike të sistemit është përcaktuar minimumi i spesorit dhe presionit që duhet të durojnë tubacionet dhe elementët e sigurisë së sistemit sipas standardeve përkatëse. Përmasat e tubacioneve, fllanxhave dhe elementet e tjerë janë kërkuar referuar hapësirave fizike të vendit ku do të montohen, përmasave të daljeve të pompave ekzistuese të drenazheve dhe tubacionit të shkarkimit në biefin e poshtëm.

Dalja e tubacionit të shkarkimit në biefin e poshtëm linjave të drenazhit është në nivelin e ujit të rezervuarit. Gjithashtu kuota e vendit ku do të instalohet sistemi i ri në sallën e makinerive është nën kuotën e ujit në biefin e poshtëm, për këtë arsye në momentin e demontimit të sistemit ekzistues në rast se nuk izolohet tubacioni i shkarkimit të ujit në biefin e poshtëm do të futet uji nga biefi i poshtëm në sallën e makinerive. Për të shmangur këtë është e nevojshme të realizohet izolimi i tubacionit të shkarkimit në biefin e poshtëm, punime këto të cilat do të realizohen në nivelin e ujit dhe kërkojnë polumbarë.

Njësia e Prokurimit